

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Gjirokastër

PROGRAMI
I KURSIT TË VEÇANTË
“RROBAQEPËSI PËR FASONËRI”

Kodi: RRF-19

Miratoi:

DREJTORI

.....

Gjirokastër, 2019

PROGRAMI I KURSIT TE VECANTE

“RROBAQEPËSI PËR FASONËRI”

(RRF-19)

I. Profili i profesional i rrobaqepësit për fasonëri

a) Karakteristikat e rrobaqepësit për fasonëri

Rrobaqepësi për fasonëri është i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar në ndërmarrje apo reparte rrobaqepësi për fasonëri të prodhimit të veshjeve.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, rrobaqepësi në fasonëri duhet të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, **shprehi** profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale në fushën e rrobaqepësisë në fasonëri.

Suksesi i rrobaqepësit në fasonëri është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqëndrimi, korrektësia, disiplina, etika e komunikimit, saktësia, etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës, të lidhura ngushtë me suksesin në punë.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e rrobaqepësit për fasonëri

Profesioni i rrobaqepësit për fasonëri është i lidhur ngushtë me procedurat e punës në një repart rrobaqepësie fasonëri, duke njohur nga afër të gjitha makineritë dhe proceset e punës në gjithë linjën e prodhimit në repart rrobaqepësie për fasonëri. Ai mund të punësohet në fabrika dhe reparte rrobaqepësi për fasonëri të prodhimit të veshjeve si punëtor/e në linjën e prodhimit.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e punëtor/es/it të kualifikuar, kontrollor/e i/e prodhimit në linjë apo drejtues/e reparti për prodhimin e veshjeve të ndryshme.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Rrobaqepësi”, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Rrobaqepësi për fasonëri,,

Në përfundim të Kursit për Rrobaqepësi për fasonëri, kursantët duhet të jenë të aftë të:

- parapërgatisin vendin e punës për fillimin e punës;
- përzgjedhin dhe përdorin mjetet dhe materialet e punës;
- përgatisin mjetet dhe makinat për punë;
- kryejnë të gjitha punimet në makinat e linjës së prodhimit rrobaqepësi për fasonëri;
- kryejnë kontrollin përfundimtar të produktit;
- kryejnë hekurosjen e produktit;
- kryejnë paketimin e prodhimit;
- kryejnë riparime të ndryshme sipas rastit (defektet);
- kryejnë mirëmbajtjen e veglave dhe pajisjeve të punës;
- plotësojnë dokumentacionin teknik për punimet e kryera;
- kujdesen për mbetjet teknologjike;
- zbatojnë rregullat e higjienës personale dhe të mjedisit të punës;
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit;

- kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimet e veshjeve në rrobaqepësi për fasonëri;
- zbatojnë standardet ndërkombëtare në rrobaqepësi për fasonëri;
- komunikojnë me etikë profesionale me eprorët, kolegët, klientët;
- zbatojnë kërkesat për licensim për ushtrim profesioni.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Rrobaqepësi për fasonëri”.

Pjesëmarrësit në Kursin për “Rrobaqepësi për fasonëri” duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Rrobaqepësi për fasonëri”

130 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Rrobaqepësi për fasonëri”

Nr.	Titulli i modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1.	Njohuri të përgjithshme mbi profesionin e rrobaqepësit për fasonëri.	RRF-01-19	5 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të rrobaqepësit për fasoneri. 2. Kursanti përshkruan materialet dhe mjetet e punës në repart fasonërie. 3. Kursanti përshkruan rregullat e komunikimit, sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit në repartin e punës.
2.	Qepja me makinat qepëse në linjën e prodhimit në rrobaqepësi fasonëri	RRF-02-19	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan makinën e syzatorit: ndërtimi, funksionimi, përdorimi. 2. Kursanti përgatit për punë syzatorin. 3. Kursanti realizon qepje në makinat qepëse syzator. 4. Kursanti përshkruan makinën qepëse: ndërtimi, funksionimi, përdorimi. 5. Kursanti përgatit për punë makinën qepëse. 6. Kursanti realizon qepje në makinat qepëse. 7. Kursanti përshkruan makinën e birkopsave: ndërtimi, funksionimi, përdorimi. 8. Kursanti përgatit për punë makinën qepëse të birkopsave. 9. Kursanti realizon qepje në makinat e birkopsave.

3.	Proceset përfundimtare në linjën e prodhimit në rrobaqepësi fasonëri	RRF-03-19	25 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan pastrimin e prodhimit, rëndësinë, llojet e tij. 2. Kursanti kryen pastrimin e prodhimit me dorë. 3. Kursanti kryen pastrimin e prodhimit me makinë. 4. Kursanti përshkruan hekurat për hekurosje: ndërtimi, funksionimi, përdorimi. 5. Kursanti përshkruan procesin e hekurosjes së prodhimit, rëndësia, llojet (përgatitore gjatë proceseve përfundimtare). 6. Kursanti kryen hekurosje. 7. Kursanti përshkruan dhe realizon kontrollin e cilësisë së prodhimit. 8. Kursanti përshkruan dhe realizon proceset e fundit të prodhimit (matja, etiketimi, paketimi).
----	--	-----------	--	--

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktori i kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesi i Moduleve të Kursit për “Rrobaqepësi për fasonëri”

1. Moduli “Njohuri të përgjithshme mbi profesionin e “Rrobaqepësit për fasonëri”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	NJOHURI TË PËRGJITHSHME MBI PROFESIONINE RROBAQEPËST PËR FASONËRI	RRF-01-19
Qëllimi i modulit	Ky modul i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të rrobaqepësit në repart fasonerie, rregullat e përgjithshme të punës, si dhe rregullat e komunikimit, sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit në repartin e rrobaqepësisë për fasonëri.	
Kohëzgjatja e modulit	5 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer i pranimit	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të rrobaqepësit për fasonëri. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë rëndësinë e sektorit të rrobaqepësisë në fasonëri në ekonominë e vendit; - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës në repart rrobaqepësie për fasonëri; - të përshkruajë mjediset dhe kushtet e punës në repart rrobaqepësie për fasonëri; - të përshkruajë proceset bazë të rrobaqepësisë për fasonëri; - të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdor rrobaqepësi; - të përshkruajë organizimin e punës në rrobaqepësi; - të përshkruajë kërkesat profesionale për punonjësin në repart rrobaqepësie për fasonëri; - të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të punonjësit në repart rrobaqepësie për fasonëri. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim

-

RM 2 Kursanti përshkruan materialet dhe mjetet e punës në repart fasonërie.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të dallojë materialet bazë që përdoren në rrobaqepësi fasoneri;
- të përshkruajë materialet ndihmëse;
- të përshkruajë proceset bazë në repart rrobaqepësie për fasoneri;
- të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdoren në repart rrobaqepësie për fasoneri;
- të përshkruajë organizimin e punës në repart rrobaqepësie për fasoneri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 3 Kursanti përshkruan rregullat e komunikimit, sigurisë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit në repartin e punës.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rëndësinë dhe rregullat e komunikimit me etikë profesionale në ambientin e punës;
- të përshkruajë rëndësinë dhe rregullat e sigurimit teknik që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen nga rryma elektrike, dëmtimet nga makinat dhe pajisjet prerëse, dëmtimet nga nxehtësia dhe zjarri etj.;
- të përshkruajë masat dhe mjetet për mbrojtjen nga zjarri;
- të përshkruajë masat dhe mjetet për dhënien e ndihmës së parë për të dëmtuarit;
- të përshkruajë rregullat e higjienës personale dhe asaj të mjediseve të punës;
- të përshkruajë rëndësinë dhe rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë punës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

**Udhëzime
për zbatimin e
modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të repartit të rrobaqepësisë për fasoneri.
 - Instruktori gjatë shpjegimit duhet të përdorë për ilustrim materiale pamore apo objekte konkrete.
 - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin e rrobaqepësisë për fasoneri. Atyre duhet t'u jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit, me funksionet,
-

	detyrat dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e rrobaqepësit për fasoneri. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të mësuar
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makineritë dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në repart rrobaqepësi fasoneri - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme në repart Rrobaqepësie për fasoneri - Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul. - Lëndë të para dhe ndihmëse që mundësojnë praktikimin e kursantëve.

2. Moduli “Qepja me makinat qepëse në linjën e prodhimit në rrobaqepësi për fasonëri”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	QEPJA ME MAKINAT QEPËSE NË LINJËN E PRODHIMIT NË RROBAQEPËSI FASONERI	RRF-02-19
Qëllimi i modulit	Ky modul i njeh kursantët me makinat qepëse që përdoren në linjën e prodhimit në repart rrobaqepësie për fasonëri, si dhe i aftëson t’i përdorin ato. Gjithashtu ky modul i aftëson kursantët të rregullojnë defektet e thjeshta gjatë proceseve të qepjes me makinat qepëse.	
Kohëzgjatja e modulit	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer i pranimit	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç. Të ketë përfunduar modulën “Njohuri të përgjithshme mbi profesionin e “Rrobaqepësit për fasonëri”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan makinën e syzatorit: ndërtimi, funksionimi, përdorimi. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë rëndësinë e përdorimit të makinës syzator në repart rrobaqepësie për fasonëri; - të përshkruajë funksionet e makinës syzator; - të tregojë ndërtimin e përgjithshëm të makinës syzator; - të përshkruajë funksionet e pjesëve kryesore të saj; - të tregojë mënyrën e vendosjes së fillit në makinën syzator; - të tregojë mënyrën e përgatitjes për punë të syzatorit; - të përshkruajë kujdesin dhe mirëmbajtjen e makinës syzator; - të përshkruajë rregullat e sigurisë gjatë përdorimit të makinës syzator; - të komunikojë me etikë profesionale. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë RM 2 Kursanti përgatit për punë syzatorin. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:	

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës në makinën qepëse syzator;
- të përzgjedhë materialet e punës;
- të përgatisë për punë makinën qepëse syzator;
- të kontrollojë pjesët e makinës qepëse syzator;
- të vendosë dhe të fiksojë fijet dhe gjilpërën e duhur;
- të regjistrojë hapin e tegelit sipas parametrave të duhur;
- të regjistrojë shpejtësinë e makinës sipas proceseve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti realizon qepje në makinat qepëse syzator.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës në makinën qepëse syzator;
- të përzgjedhë materialet e punës;
- të përgatisë për punë makinën qepëse syzator;
- të kontrollojë pjesët e makinës qepëse syzator;
- të vendosë dhe të fiksojë fijet dhe gjilpërën e duhur;
- të rregjistrojë hapin e tegelit sipas procesit dhe llojit të tekstilit;
- të rregjistrojë shpejtësinë e makinës sipas proceseve;
- të kryejë qepje të ndryshme me makinën syzator;
- të rregullojë defekte të thjeshta të punës në makinën syzator;
- të pastrojë vendin e punës;
- të mirëmbajë makinën syzator duke i kryer pastrim dhe vajosje;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti përshkruan makinën qepëse: ndërtimi, funksionimi, përdorimi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- të argumentojë rëndësinë e përdorimit të makinave qepëse në rrobaqepësi për fasonëri;
- të përshkruajë funksionet e makinave qepëse;
- të tregojë ndërtimin e përgjithshëm të makinës qepëse, si dhe funksionet e pjesëve kryesore të saj;
- të bëjë dallimin e makinave qepëse dhe proceseve që realizohen në to (lineare, dygjilpërësh, rel etj.);

- të tregojë mënyrën e vendosjes së fillit në makinë qepëse;
- të tregojë mënyrën e mbushjes së suvajkes;
- të përshkruajë masat për kujdesin dhe mirëmbajtjen e makinave qepëse;
- të përshkruajë rregullat e sigurisë gjatë përdorimit të makinave qepëse;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 5 Kursanti përgatit për punë makinën qepëse.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës në makinën qepëse;
- të përzgjedhë materialet e punës;
- të kontrollojë pjesët e makinës qepëse;
- të vendosë gjilpërën në makinë në mënyrën e duhur;
- të vendosë perin e sipërm;
- të kontrollojë lirimimin dhe shtrëngimin e perit;
- të mbërthejë (zbërthejë) folenë e masurit në makinën qepëse;
- të kryejë mbushjen e masurit me pe;
- të vendosë dhe të fiksojë fijen, gjilpërën e duhur dhe masurin në makinë;
- të regjistrojë hapin e tegelit sipas procesit dhe llojit të tekstilit;
- të regjistrojë shpejtësinë e makinës sipas proceseve që do të realizojë.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 6 Kursanti realizon qepje në makinat qepëse.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet e qepjeve me makinë qepëse dhe përdorimet e tyre;
- të përshkruajë llojet kryesore të tegelave për qepje me makinë qepëse njëgjilpërëshe;
- të realizojë tegela me makinë qepëse. njëgjilpërëshe me gazi të thjeshtë, cimb, këmbëtreshë, këmbë makine, etj.;
- të rregullojë defekte të thjeshta të punës në makinën njëgjilpërëshe;
- të përshkruajë llojet kryesore të tegelave për qepje me makinë qepëse dygjilpërëshe;
- të realizojë tegela në jaka, mëngë, kthim të fundeve të pantallonave, etj.;

- të rregullojë defekte të thjeshta të punës në makinën dygjilpërëshe;
- të përshkruajë llojet kryesore të tegelave për qepje me makinë rel;
- të realizojë tegela në makinë rel;
- të rregullojë defekte të thjeshta të punës në makinën qepëse rel;
- të pastrojë vendin e punës;
- të mirëmbajë makinën qepëse (pastrim dhe vajosje);
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 7 Kursanti përshkruan makinën e birkopsave: ndërtimi, funksionimi, përdorimi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të argumentojë rëndësinë e përdorimit të makinës së birkopsave në repart rrobaqepësie për fasonëri;
- të përshkruajë funksionet e makinës së birkopsave;
- të tregojë ndërtimin e përgjithshëm të makinës së birkopsave;
- të përshkruajë funksionet e pjesëve kryesore të saj;
- të tregojë mënyrën e vendosjes së fillit në makinën e birkopsave;
- të tregojë mënyrën e përgatitjes për punë të makinës së birkopsave;
- të përshkruajë kujdesin dhe mirëmbajtjen e makinës së birkopsave;
- të përshkruajë rregullat e sigurisë gjatë përdorimit të makinës së birkopsave;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 8 Kursanti përgatit për punë makinën qepëse të birkopsave.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepje në makinën qepëse të birkopsave;
- të përzgjedhë materialet e punës;
- të rregullojë parametrat e makinës për bërjen e brimave sipas tekstileve;
- të rregullojë parametrat e makinës për qepjen e kopsave.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 9 Kursanti realizon qepje në makinat e birkopsave.**Kriteret e vlerësimit:**

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të qepë brimat në makinën e birkopsave duke zbatuar procedurat e punës;
- të qepë kopsa duke zbatuar procedurat e punës;
- të rregullojë defekte të thjeshta në makinat e qepjes së birkopsave;
- të pastrojë vendin e punës;
- të mirëmbajë makinën qepëse të birkopsave (pastrim dhe vajosje);
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të komunikojë me etikë profesionale.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

**Udhëzime
për zbatimin e
modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të repartit të rrobaqepësisë për fasoneri.
- Instruktori gjatë shpjegimit duhet të përdorë për ilustrim materiale pamore apo objekte konkrete, si dhe demonstrime të proeeseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në rrobaqepësi për fasonë, duke iu dhënë detyra praktike për të kryer procese të qepjeve të ndryshme me makinën qepëse syzator, qepëse njëgjilpërshe, dygjilpërshe, rel, birkopsa industriale që përdoren në repart rrobaqepësie për fasonë. Praktika të jetë fillimisht e mbikqyrur dhe më pas e pavarur.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që duhet të arrihen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të mësuar.

**Kushtet e
domosdoshme
për realizimin
e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makineritë dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në repart rrobaqepësie për fasoneri.
 - Makina qepëse industriale.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme në repart rrobaqepësie për fasoneri.
-

- Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
- Lëndë të para dhe ndihmëse që mundësojnë praktikimin e kursantëve.

3. Moduli “Proceset përfundimtare në linjën e prodhimit në rrobaqepësi fasoneri”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PROCESET PËRFUNDIMTARE NË LINJËN E PRODHIMIT NË RROBAQEPËSI PËR FASONERI	RRF-03-19
Qëllimi i modulit	Ky modul i njeh kursantët me proceset përfundimtare në linjën e prodhimit në repart rrobaqepësie për fasoneri, si dhe i aftëson t’i realizojnë ato.	
Kohëzgjatja e modulit	25 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer i pranimit	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç. Të ketë përfunduar modulet “Njohuri të përgjithshme mbi profesionin e “Rrobaqepësit për fasoneri” dhe “Qepje me makinat qepëse në linjën e prodhimit në rrobaqepësi për fasoneri”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan pastrimin e prodhimit, rëndësinë, llojet e tij. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë rëndësinë e aplikimit të procesit të pastrimit të prodhimit; - të tregojë llojet e pastrimit të prodhimit (me dorë, me makinë); - të tregojë ndryshimet, avantazhet dhe disavantazhet, rastet e përdorimit të tyre. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim RM 2 Kursanti kryen pastrimin e prodhimit me dorë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përgatisë vendin e punës; - të përzgjedhë veglat, materialet dhe pajisjet e nevojshme për punë; - të kryejë procesin e pastrimit të prodhimit me dorë; - të sistemojë mjetet dhe vendin e punë;	

- të komunikojë me etikë profesionale;
- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë pastrimit të prodhimit me dorë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti kryen pastrimin e prodhimit me makinë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës;
- të përgatisë makinën e pastrimit të prodhimit për punë;
- të kryejë procesin e pastrimit të prodhimit me makinë;
- të sistemojë dhe pastrojë vendin e punës;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të respektojë rregullat e higjienës dhe mbrojtjes në punë gjatë të pastrimit të prodhimit me makinë;
- të mirëmbajë makinën e pastrimit të prodhimit (pastrim dhe vajosje);
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti përshkruan hekurat për hekurosje: ndërtimi, funksionimi, përdorimi.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë parametrat e hekurosjes sipas tekstilit;
- të përzgjedhë mjetet për hekurosjen dhe të tregojë përdorimet e tyre në rrobaqepsi për fasoneri;
- të përshkruajë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e llojeve të ndryshme të hekurave për hekurosje (hekur i thjeshtë, hekur me avull, hekur me gradim temperature, presë etj.);
- të përshkruajë ndërtimin dhe përdorimin e tavolinave të ndryshme për hekurosje;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Kursanti përshkruan procesin e hekurosjes së prodhimit rëndësia, llojet (përgatitore gjatë proceseve përfundimtare).

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të argumentojë rëndësinë dhe përdorimet e hekurosjes në repart rrobaqepsie për fasonëri;
- të përshkruajë llojet e hekurosjeve të prodhimit në repart rrobaqepsie për fasonëri;
- të përshkruajë rëndësinë e hekurosjes përgatitore;
- të përshkruajë rëndësinë e hekurosjes gjatë proceseve;
- të përshkruajë rëndësinë e hekurosjes përfundimtare;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 6 Kursanti kryen hekurosje.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për hekurosje;
- të përcaktojë parametrat e hekurosjes;
- të kryejë hekurosje të pjesëve të ndryshme të veshjeve, me hekur të thjeshtë për hekurosje;
- të kryejë hekurosje të pjesëve të ndryshme të veshjeve me hekur me avull dhe me gradim temperature;
- të kryejë hekurosje të pjesëve të ndryshme të veshjeve, me presë;
- të përdorë jastëk të formave të ndryshme, për hekurosjen e pjesëve të veçanta të veshjeve;
- të sistemojë dhe mirëmbajë vendin dhe mjetet për hekurosje;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 7 Kursanti përshkruan dhe realizon kontrollin e cilësisë së prodhimit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë rëndësinë e aplikimit të kontrollit të prodhimit;
- të përshkruajë llojet e kontrollit të cilësisë;
- të realizojë kontrollin e cilësisë në linjë (gjatë prodhimit);
- të realizojë kontrollin përfundimtar të prodhimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 8 Kursanti përshkruan dhe realizon proceset e fundit të prodhimit (matja, etiketimi, paketimi).

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë të:

- të përshkruajë rëndësinë e aplikimit të proceseve të fundit të prodhimit;
- të përshkruajë proceset e fundit të prodhimit;
- të përshkruajë veglat dhe materialet për proceset e fundit të prodhimit;
- të realizojë matjen e prodhimit;
- të realizojë vendosjen e etiketës;
- të realizojë palosjen e prodhimit;
- të realizojë vendosjen e prodhimit në plasmas;
- të realizojë vendosjen e prodhimit në kutitë e kartonit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli

**Udhëzime
për zbatimin e
modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës të repartit të rrobaqepësisë për fasonëri. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të rrobaqepësisë për fasonëri.
 - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe të stimulimit.
 - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në rrobaqepësi për fasonë. Atyre duhet t'u jepen detyra praktike për realizimin e proceseve të punës sipas trajtimit në modul, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
 - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që duhet të arrihen në këtë modul.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të mësuar.
-

**Kushtet e
domosdoshme
për realizimin
e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makineritë dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në repart rrobaqepësi fasoneri.
 - Makina qepëse industrial.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme në repart rrobaqepësie për fasonëri.
 - Kataloge, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Lëndë të para dhe ndihmëse që mundësojnë praktikimin e kursantëve.
-